

## **Konsultat kombëtare me shoqërinë civile për nismën KOMRA**

Zagreb, Kroaci

16.07.2008

Konsultat i organizoi Documenta. Në tubim morën pjesë 29 përfaqësues të shoqërisë civile në Kroaci. Vesna Teršelič (Documenta) dhe Eugen Jakovčić (TV Jadran – emisioni *Cenzura*) informuan pjesëmarrësit mbi rrjedhën e konsultave, instrumentet për zbardhjen e së vërtetës, nismën për themelimin e Komisionit Rajonal, si dhe për formimin e Koalicionit mbështetës për KOMRA. Është paralajmëruar se koalicioni do të prezantohet formalisht në Forumin e katërt rajonal në Prishtinë, që mbahet në tetor të vitit 2008.

Të gjithë pjesëmarrësit i dhanë përkrahje qasjes rajonale duke konsideruar se vetëm kështu mund të konstatohen të gjitha faktet mbi krimet e luftës dhe fati i personave të zhdukur.

Është theksuar rëndësia e mbledhjes së shënimeve për të gjitha viktimat e luftës si dhe rëndësia e gjyqimit të krimeve të luftës. Por, është shprehur edhe brengosja për shkak të ngadalësisë së hetimeve dhe animet etnik që është prezent në procesimin e krimeve të luftës.

Është konkluduar se nisma duhet të përfshijë spektrin sa më të gjerë të organizatave të shoqërisë civile dhe se përkrahja për nismën duhet kërkohet edhe në nivelin lokal. Për këtë qëllim, duhet të organizohet prezantimi, promovimi dhe avokimi i nismën ku do duhej të kyçen organizatat e nivelit lokal.

Është shtruar edhe pyetja se a duhet nisma të vendoset në një kontekst më të gjerë dhe a duhet të kyçen BE, OSBE dhe Tribunali ndërkombëtarë për ish Jugosllavi.